



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

PROGRAMI

I MBLEDHJES SË DYTË TË KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË PAGESAVE (KKSP)

e cila mbahet në Bankën e Shqipërisë

të martën, datë 24 Maj 2016, nga ora 10.00 deri 13.30

A. Fjala hyrëse e Kryetarit dhe prezantimi i zhvillimeve më të fundit në fushën e inovacionit si dhe forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional.

10:00-11:20

1. Fjalë hyrëse	
	Paraqet: Banka e Shqipërisë
10.00 – 10.10 Kryetari i KKSP, Zj. Elisabeta Gjoni në fjalën e saj hyrëse do të përmendë, veç të tjerash, edhe projektet që planifikon të ndërmarë Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Botërore, në kuadër të promovimit të sigurisë dhe efikasitetit të sistemeve dhe instrumenteve të pagesave.	
2. Prezantimi i zhvillimeve më të fundit në fushën e inovacionit si dhe forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional	Për informacion Paraqet: <ul style="list-style-type: none">• Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike• Ministria e Punëve të Brendshme• Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes• Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
a. 10.10 – 10.20 Teknologjia e informacionit dhe zhvillimi i instrumenteve të pagesave – Zj. Milena Harito, Ministër i Inovacionit dhe Administratës Publike do të prezantojë zhvillimet më të fundit në lidhje me projektin e- Albania si dhe projekte të tjera të ndërmarra. Në kuadër të realizimit të projektit të debitimit direkt ndërbankar brenda afateve, nevojitet angazhimi i Ministrisë për krijimin e urave të komunikimit mes kompanitve utilitare dhe bankave tregtare për këtë qëllim. Gjithashtu, pritet angazhimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, në bashkëpunimin me Shoqatën Shqiptare të Bankave për standartizimin e formatit të urdhër-pagesave të qeverisë.	
b. 10.20 – 10.30 Nxitja e sigurisë në shërbimeve bankare dhe financiare nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstitucional – Zj. Elona Gjebrea, Zëvendësministër i Punëve të Brendshme do të prezantojë zhvillimet më të fundit mbi projektet e Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi krijimin e regjistrat elektronik të Gjendjes Civile dhe Adresarit.	
c. 10.30 – 10.40 Ndërveprimi ndërinstitucional në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit instrumenteve të pagesave në shërbimet e ofruara – Z. Ervin Mete, Zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes do të prezantojë kompetencat e Ministrisë në kuadër të mbrojtjes së Konsumatorëve nga pikëpamja e shërbimeve bankare dhe financiare, dhe nevojat për bashkëpunim në kuadër të krijimit të strukturave dhe procedurave të ngjashme me ato të Bashkimit Evropian .	
d. 10.40 – 10.50 Nevoja e bashkëpunimit të autoriteteve rregullative për zhvillimin, rregullim dhe mbikëqyrjen e infrastrukturave të klerimit dhe të shlyerjes së titujve – Zj. Enkelejda	

Shehi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare prezanton kompetencat e institucionit mbi infrastrukturat e klerimit dhe të shlyerjes së titujve dhe projektet për të ardhmen në kuadër të konsolidimit të bashkëpunimit midis AMF dhe BSH në kuadër të rregullimit dhe mbikëqyrjes së këtyre infrastrukturave.

10.50-11.00 *Pushim për kafe*

11.00-11.20 – Vizitë në Muzeun e Bankës së Shqipërisë

B. Zhvillimet në Sistemet dhe Instrumentet e Pagesave, si dhe ecuria e projekteve të deritanishme në përmbushje të strategjisë afatmesme të KKSP.

11:30-12:20

<p>3. Zhvillimet më të fundit në sistemet dhe instrumentet e pagesave si dhe ecuria e plotësimit të rekomandimeve të Komitetit.</p>	<p>Për diskutim</p> <p>Paraqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Banka e Shqipërisë • Shoqata Shqiptare e Bankave
<p>a. 11.20 – 11.30 Zhvillimet e sistemeve të pagesave dhe hapësirat për zhvillim – Zj. Anjeza Beja, Drejtor i Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës prezanton zhvillimet më të fundit në sistemet dhe instrumentet e pagesave, si dhe ecurinë e tre projekteve të ndërmarrë në vijim të rekomandimeve të KKSP në mbledhjen e parë në lidhje me: pyetësin për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në euro brenda vendit, standardizimin e urdhër-transferës si dhe debitimin direkt ndërbankar.</p> <p>b. 11.30– 11.40 Diskutime mbi mundësitë e zhvillimit të infrastrukturës së klerimit dhe të shlyerjes së pagesave në euro brenda vendit nga ana e sistemit bankar – Z. Frédéric Blanc, Anëtarë i Bordit Drejtues të Shoqatës Shqiptare të Bankave, do të paraqesë rezultatet e pyetësorit dhe mundësitë dhe interesin e bankave të ndërmarrin një nisëm të tillë, në bazë të këtyre rezultateve.</p> <p>c. 11.40 – 11.50 Ndërhyrje nga Zj. Najada Xhaxha, kryetare e Komitetit të Pagesave në Shoqatën Shqiptare të Bankave, në lidhje me projektin e debitimit direkt ndërbankar si dhe hapat që do të ndjekin bankat dhe sfidat që do t'i paraqiten, me qëllim implementimin e tij brenda afateve.</p> <p>d. Nevojat dhe prioritete e sistemit bankar për ndërlidhje me regjistrin elektronik të gjendjes civile dhe adresarin - Zj. Najada Xhaxha, Kryetare e Komitetit të Pagesave pranë shoqatës Shqiptare të Bankave do të elaborojë nevojat dhe prioritete të cilat ka sistemi bankar në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe përfitimet e sistemit bankar, por dhe më gjerë nga ky bashkëpunim.</p> <p>e. 11.50 – 12.00 Përdorimi i nënshkrimit elektronik dhe nevoja për sensibilizimin e bankave me qëllim rritjen e efikasitetit të shërbimeve bankare – Z. Deniz Deralla, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë.</p> <p><i>Dokumenta mbështetës dhe informues Banka e Shqipërisë, prezantim në ppt.</i></p>	
<p>4. Strategjia Afatmesme e KKSP, arritjet dhe sfidat për të ardhmen e afërt.</p>	<p>Për diskutim</p> <p>Paraqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Banka Botërore • Të ftuar: M- Pesa, Easy Pay, Paylink, M-Pay dhe OSHEE • Banka e Shqipërisë
<p>a. 12.00 – 12.10 Zj. Maria Teresa Chimenti –Grupi i Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave pranë Bankës Botërore, do të prezantojë rezultatet e arritura deri më tani në kuadër të matjes së kostove të instrumenteve të pagesave nga kahu i kërkesës dhe më konkretisht kostot e pagesave nga perspektiva e individëve, bizneseve dhe institucioneve shtetërore. Rezultatet e këtij studimi paraqesin interes të veçantë në kuadër të zhvillimit dhe reformimit të shërbimeve të pagesave në Shqipëri dhe si rrjedhojë reduktimin e përdorimit të parasë fizike në ekonomi .</p>	

- b. **12.10 – 12.20** Ndërhyrje nga të ftuarit, përfaqësues të institucioneve financiare jobanka, operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë dhe shoqërive utilitare në lidhje me çështje që prekin aktivitetin e tyre në fushën e pagesave dhe nevojitet të adresohen në komitet.
- c. **12.20 – 12.30** Monitorimi i zbatimit të strategjisë afatmesme të KKSP dhe identifikimi i prioritetëve për të ardhmen – Zj. Anjeza Beja, *Drejtor i Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës* do të mbajë një prezantim mbi zhvillimet më të fundit në sistemet dhe instrumentet e pagesave, arritjet e deritanishme të KKSP në lidhje me objektivat e përcaktuar në strategjinë afatmesme, si dhe do të identifikojë nismat e synuara nga ana e Bankës së Shqipërisë për të ardhmen në këtë drejtim.

C. Të tjera dhe përmbledhje e projekt rekomandimeve të KKSP

12.30-12.40

5. Diskutime mbi çështje të tjera, mbi rekomandimet për në vijim dhe mbi datën e mbledhjes së rradhës	Për diskutim
	Paraqet: Sekretariati
<p>Pjesëmarrësit ftohen të diskutojnë mbi çështje me interes për KKSP dhe të cilat nuk janë parashikuar në këtë program si dhe mbi rekomandimet për mbledhjen e rradhës.</p> <p><i>Sekretariati prezanton projekt rekomandimet e KKSP</i></p> <p>Pjesëmarrësit ftohen të diskutojnë mbi datën e organizimit të mbledhjes së rradhës.</p>	
<p>12.40 – 13.40 Drekë</p>	